


KOSOVARJA

Ballina: Merita Pinta

**MERITA
PINTA,**
*gruaja
e suksesere
të mëdha*

Gëzuar
2023





2023

Urime festat e fundvitit

www.dino-company.com

E faqes së parë



**MERITA
PINTA,**
*gruaja
e suksesere
të mëdha*

Merita Pinta është nga ato femra që dritaret e mendjes i ka të hapura gjithmonë. Vizioni i saj është i mahnitshëm dhe falë këtij vizioni ajo sot është mes grave më të suksesshme shqiptare, me një karrierë të bujshme në fushën e biznesit.

Merita që nga adoleshenca e hershme jeton në Zvicër dhe është shembull për integritetin e femrës shqiptare atje dhe një afariste model.

Pinta është pronare dhe presidente bordi e firmës “Prima Pflege”, në kuadrin e së cilës funksionojnë disa qendra ose shtëpi pleqsh. Gjithashtu, është në krye të Rrjetit të Bizneseve Shqiptare në Zvicër.

Është e lindur më 15 gusht 1978, në bjeshkët e Jezercit. Kur ishte 5 vjeçe, bashkë me familje dolën me banim në Manastirc, komuna e Ferizajt.

Babai i saj, Shabani, shkoi në vitet 80 për të punuar në Zvicër. Janë 5 fëmijë. I ka dy motra dhe dy vëllezër. Si 14-vjeçare shkoi me familje në Zvicër dhe filloi të integrohej e të shkollohej në një sistem të ri dhe mjaft produktiv. Tregon se, fillimisht, nuk ishte e lehtë ndarja nga vendlindja. Nga ana tjetër, shkuarja në Zvicër ishte gëzim, por edhe sfidë për shkak të procedurave që dilnin në fazën e integritimit në një vend të huaj.

Pasi e mbaroi shkollën fillore në Arau, bëri një praktikë gjashtëmuajshe në Spitalin Kantonal të Badenit. Aty u bind se karrierën dëshiron ta vazhdojë në këtë fushë. Prandaj, e përfundoi profesionin për asistente. Para 23 vitesh u martua dhe krijoi familje me bashkëshortin, Bajram Pintën dhe i kanë dy djem.

Dëshira e madhe që të dijë e të mësojë më shumë për njeriun nuk e linte të qetë dhe, kështu, nisi ta zhvillojë planin për karrierën që e ka arritur deri tash.

Brenda 15 viteve i ka kryer studimet për infermiere, pastaj ka diplomuar në fushën pedagogjike të arsimit, ku edhe mbante përgjegjësinë kryesore për nxënësit dhe studentët në firmën ku ka punuar më parë. Tutje, Merita vazhdoi me studimet për menaxhim në institucionet shëndetësore dhe paralelisht diplomoi edhe për sigurinë e kualitetit.

Për të ka qenë një kohë me sfida e përvoja të ndryshme, por, mbi të gjitha, e mbushur dhe e pasur me mësimet jetësore.

Andaj, për të, jetën e saj profesionale dhe shumë të tjera flet në “Kosovare”...



PINTA & DOLI



Meritë, jeni grua e suksesshme. E, të shkuarën si e kujtoni?

- Kam shumë kujtime të mira nga e kaluara, por edhe shumë mund e punë të bërë ndër vite pa u ndalur. Nuk ka qenë lehtë të arrij këtu ku jam. Nuk është lehtë të jesh nënë dhe në të njëjtën kohë të zhvillosh edhe karrierë.

Për mua ka qenë një kohë me sfida, përvoja të ndryshme, por edhe e pasur me mësimet jetësore.

Punën që e bëj me shumë pasion dhe mendoj se kjo është ajo që më ka ndihmuar të kem vullnet e të mos ndalem.

Ka lënë gjurmë fëmijëria e rinia e hershme te ju?

- Kam pasur fat që kam pasur shembuj të mirë në jetën time. Jam shumë e sigurt se kjo luan një rol të madh në jetë.

Shembull pozitiv në jetën time ishin prindërit që më falën gjithë jetën dashuri dhe më edukuan si më së miri...

Një rol të madh në jetën time ka luajtur edhe mësuesi Feriz në shkollën fillore. Gjithashtu,

më kujtohet dhe i jam mirënjohëse arsimtarit Daut, që është kujdesur shumë për të na informuar sa më mirë për tema kulturore dhe ato sportive.

Në shkollë kam qenë shumë aktive në aktivitetet kulturore, artistike dhe, gjithashtu, në sport, konkretisht në volejball.

Më vonë, në Zvicër kam zënë për dy vite me radhë vendin e parë në sport, në grupin e femrave në shkollën Rapperswil. Në vitin e fundit shkollor kam marrë pjesë në një sfilatë mode në Buchs Aarau, ku edhe u zgjedha si fituese e vendit të parë. Nga ajo ngjarje pata mundësi të modeloj për "Blackout", që është brend i njohur për xhins në Zvicër.

Kjo, në fakt, nuk ishte bota ime, andaj edhe nuk e kam zhvilluar interesin në këtë drejtim. Por, gjithsesi, ishte një përvojë e mirë.

A u kujtohet koha kur e braktisët vendlindjen dhe cili është kujtimi që nuk fshihet nga ajo periudhë?

- Po, më kujtohet shumë mirë. Fillimi nuk ishte edhe aq i lehtë, por ia dolëm. E, për t'u integruar në Zvicër nuk e kam pasur

problem, por më mungonin shumë shoqet dhe shokët e shkollës.

Zvicra u ofroi mundësi shkollimi, integrimi e punësimi, kurse Kosovën nuk e keni harruar asnjëherë, a?

- Jam shumë falënderuese për mundësitë që na dha Zvicra. Por, vendlindjen nuk e harroj kurrë. Dëshira është shumë e madhe për të kontribuar me përvojën time profesionale për vendim tim.

Këtë nuk do e lë vetëm dëshirë, por do vijë koha e duhur kur kjo ëndërr do bëhet realitet.

Përse e zgjodhët këtë profesion?

- Zgjedha këtë profesion se doja të mësoja e të dija më shumë për njeriun. Njeriu është, vërtet, një mrekulli se si funksionon trupi e truri i njeriut në një kompleksitet shumë të lartë.

A u kujtohet puna e parë?

- Po, punën e parë e kam bërë praktikante në Spitalin e Badenit.

Tani jeni femër afariste e suksesshme. A mund të flasim pak për aktivitetet tuaja aktuale?

- Në muajin gusht të vitit 2020, "Prima Pflege" kremtoi vitin jubilar, gjegjësisht pesëvjetorin e themelimit. Jam shumë e lumtur me të gjitha arritjet deri më tani.

Për pesëvjetor arritëm të hapim edhe një repart të ri në Bad Zurzach "Wohnen im Park", me 26 shtretër, ku edhe kam bërë themelimin dhe integrimin e Inhouse-Spitex. Ky repart veçon konceptin me repartin që e kemi deri më tani në Bad Zurzach.

"Wohnen im Park" është shumë i përshtatshëm për çifte që duan të banojnë së bashku dhe u duhet përkujdesje në disa aktivitete të ditës.

Në këtë repart klientët tanë e përcaktojnë vetë se cilat shërbime u duhen gjatë 24 orëve.

Aktualisht jam shumë e angazhuar për një projekt të ri, që hapet nga viti 2023. Aty i kemi edhe 90 banesa për të moshuarit, në bashkëpunim me kompaninë e njohur "Domum", ku "Prima Pflege" i shërben klientëve direkt në banesën e tyre për përkujdesje dhe do të ketë shërbim 24 orësh për thirrjet emergjente.

A mund të na tregoni se ku gjenden, më saktësisht, shtëpitë e pleqve të "Prima Pflege"?

- Shtëpitë janë të gjitha në kantonin e Aargaut. Nën mbikëqyrjen e "Prima Pflege" janë këto shtëpi/reparte për përkujdesje: "Residenz im Rebberg Tegerfelden", "Residenz im Park Bad Zurzach", "Wohnen im Park Bad Zurzach", "Föhrengarten në Eiken" dhe "Inhouse Spitex Residenz im Park" në Bad Zurzach.

A ka edhe shqiptarë të punësuar në këto shtëpi?

- Po, kemi edhe punëtorë shqiptarë. Mund të them lirisht se janë mjaft të talentuar në këtë fushë. Kemi, gjithashtu, edhe shumë

studentë shqiptarë që bëjnë punë praktike në firmën tonë.

Çka mendoni për trajtimin e të moshuarve në Kosovë dhe cila do të ishte këshilla juaj për shoqërinë dhe institucionet tona?

- Të bëhet një analizë e përgjithshme në këtë sektor. Të analizohet, gjithashtu, programi arsimor i infermierëve.

Unë nuk e njoh mirë sistemin e shëndetësisë në Kosovë. Për atë edhe mundem vetëm të këshilloj në përgjithësi në këtë drejtim. Gjithashtu, është me rëndësi të krijohen partneritete me ekspertë profesionistë shqiptarë që punojnë dhe veprojnë jashtë vendit. Rrjetizimi është tash për tash i domosdoshëm në të gjitha lëmit.

Kosova e ka një pasuri të madhe, e ata janë të rinjtë dhe, me siguri, qëndron interesi dhe mundësia të zhvillohen projekte në fushën e infermierisë, në bashkëpunim me vendet evropiane.

Ndërkohë, ju tashmë jeni zgjedhur në krye të Rrjetit të Bizneseve Shqiptare në Zvicër. Privilegj a përgjegjësi?

- Besoj se është një kombinim, por, me siguri, edhe një përgjegjësi e madhe. Në Zvicër kemi një potencial jashtëzakonisht të lartë në shumë sektorë të bizneseve. Zvicra është vend i mundësive.

Mendoj se së bashku e kemi bërë hapin e duhur. Kemi treguar një gatishmëri për ndryshim dhe jam shumë e bindur se së bashku do t'i arrijmë qëllimet e duhura sa i përket misionit të Rrjetit.

Rrjetin e Bizneseve e shoh, gjithashtu, një urë lidhëse strategjike ndërmjet Zvicrës dhe trojeve shqiptare e me gjerë.

Po ashtu, do i përforcojmë lidhjet dhe bashkëpunimet me rrjetet e tjerë...

Si po funksionon Rrjeti i Bizneseve Shqiptare në Zvicër?

- Rrjeti funksionon shumë mirë. Punojmë rreth zhvillimit të disa sektorëve e temave të

ndryshme të botës së biznesit.

Mediet shkruajnë se ju jeni shqiptarja që fitoni miliona. A qëndron kjo?

- Për shifra nuk flas publikisht. Për mendimin tim, ato media që shkruajnë në atë mënyrë, nuk janë profesionale.

Tjetër, nuk është etike e as e ndërgjegjshme të flasim për shifra publikisht, ndërkohë që shumë familje në Kosovë e në vende të tjera shqiptare nuk kanë bukë mjaftueshëm për të ngrënë.

Për shifra flitet ku është vendi i duhur...

Cila është jeta juaj private jashtë profesionit, punëve e angazhimeve?

- Jetën private mendohem ta kaloj me njerëz që i dua dhe i respektoj shumë.

E dua artin, muzikën dhe zhvillimin e disa aspekteve të jetës. I adhuroj shumë bisedat e mira dhe konstruktive.

Jemi në prag të festës së Vitit të Ri. Andaj, është e natyrshme të të pyes si dhe për çka do ta kujtosh vitin 2022?

- Viti 2022, në përgjithësi, ishte vit i suksesshëm për mua. Jam e kënaqur që nuk ishte më temë pandemia, siç ishte dy vite më parë. Janë hapur dyer të reja bashkëpunimi...

I gëzohem vitit të ardhshëm me shumë punë dhe projekte të reja që nuk i kam bërë akoma publike. Ajo që nuk do ta harroj asnjëherë ishte festa për firmën time "Prima Pflege", që e mbajtëm më 10 dhjetor në Baden.

E falënderoj shumë Shkëlzen Dolin për idenë dhe realizimin e këtij eventi madhështor!

Porosia juaj për shqiptarët?

- Porosi nuk kam, e urime po. Andaj, për zemërsisht u uroj të gjithë shqiptarëve anë e mbanë globit të gjitha të mirat për festat e fundvitit!

Nderim Neziri



FAQJA E SHTATË

NJË GËZUAR PËR JETËN!



Njerëzit apo koha fajtores?

Sa keq: Sot vuajtjet e njerit janë kënaqësi e tjetrit!

Dikujt edhe shpirtin t'ia falësh nuk ta vlerëson kurrë! Nguten të të harrojnë kur nuk kanë nevojë më për ty.

E, dihet se gjithçka që jeton nuk jeton vetëm, as veç për vetveten...

Im at thoshte: Të rrëzohesh shtatë herë dhe të ngrihesh tetë herë, ky është sekreti i jetës!

U kujtohet kur ishim fëmijë - rrëzoheshim e lëndoheshim dhe prapë vazhdonim lojën, ecjen...

Nga hapat e gabuar mësojmë edhe të ecim...

E thotë përvoja: Barku i uritur dhe xhepi i zbrazët të japin mësimet më të mira në jetë!

Ma tërhoqën vëmendjen fjalët e njerit që rrinte i vetëm në tarracën e kafenesë "Pini", i cili, me gjysmë zëri, këndonte:

"Ah moj jetë, jetë me hile..."

Pse me t'keqin u bëre i mirë

E me t'mirin u bëre katil?!"

Pastaj, i drejtohej vetes:

"Edhe një gotë për jetën - gëzuar!"

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Ali Kadriu: Le t'më vrasin, nuk e lëshoj shtëpinë time!

Ali Kadriu, banor në pjesën veriore të Mitrovicës, në “Kroin e Vitakut”, ka vënë flamurin kuq e zi në kulmin e kullës së tij, në shenjë rezistence të banorëve shqiptarë në këtë lagje. Ai është bërë simbol paqe dhe rezistence në këtë lagje, duke ngulur këmbë se prej aty del vetëm kur ta nxjerrin të vdekur.

I rrahur disa herë prej serbëve, fajëson qeverinë e Kosovës se nuk ka bërë asgjë për qëndrimin e shqiptarëve në këtë pjesë të Kosovës...

Serbë e shqiptarë në Lagjen “Kroi i Vitakut” në Mitrovicën Veriore andej lumit Ibër, sikur garojnë se kush do të pushtojë më shumë tokën e pronave me origjinë shqiptare.

Megjithatë, dallimet janë të mëdha: Mëhallë-mëhallë shqiptarë e serbë kanë ndërtuar në brigjet kodrinore të Vitakut, pa llogaritur në fqinjësi dhe duke kaluar heshtazi pranë njëri-tjetrit pa mirëmëngjesi e pa mirëdita.

Në këtë betejë ndëretnike, Beogradi ka qenë më luftarak, duke u dal në krahë serbëve që nuk dihet kush janë dhe prej nga vijnë, ndërsa shqiptarët, në mungesë kujdesi të qeverisë së Kosovës, nuk kanë mundur të ndërtojnë as në trojet e tyre, ku u janë djegur shtëpitë.

Andej lbrit për në Lagjen “Kroi i Vitakut” nuk ka kalimtarë rasti, pos nëse e humb ndokush rrugën...

Me të parë shtëpitë, dihet se cila e cilës palë është: Shtëpitë e vjetra dhe që kanë kulm tjegullash të vjetra janë të serbëve, ndërsa ato që kanë kulme të reja dhe me fasadë janë të shqiptarëve, sepse janë ndërtuar pas lufte, meqë u janë djegur nga serbët.

Shqiptarët janë rrahur, vrrarë e maltretuar duke punuar në trojet e veta si të pambrojtur nga askush, ndërsa serbët i përkrahë qeveria e Serbisë dhe UNMIK-u. Një luftë

e tillë ndërtimi tash, së voni, ka shënuar hapa të dukshëm favoritësh nga serbët, të cilëve Serbia u ka ndërtuar objekte kolektive banesore, banorët e të cilëve nuk i ka parë askush më parë e të cilët mendohen se janë serbë të ardhur nga Kroacia e Bosnja, por që, patjetër, dyshohet nga banorët shqiptarë se ata, shumica absolute, janë pjesëtarë të MUP-it të Serbisë.

Kur hynë në Lagjen “Kroi i Vitakut”, së pari, bien në sy vetura pa tabela regjistrimi, e që të kujton se je në një hapësirë ku nuk ka ligj.

Aty-këtu, kalimthi në “Lagjen e Doktorëve”, ndokush ndërton diçka, ndërsa, më poshtë, në shtëpitë e reja shqiptare që i ka ndërtuar qeveria e Kosovës nuk jeton askush.

ALI KADRIU, SIMBOL I QËNDRESËS NË LAGJEN “KROI I VITAKUT”

Të dielën që e vizituam, në kullën e vet me 80 frenxhi, Ali Kadriu i shpjegoi ekipit të revistës sonë, “Kosovarja” për peripecitë e shqiptarëve që të kthehen në shtëpitë e tyre.

Ai tregonte me dorë se kah janë serbët e kah shqiptarët, pa ua pasur frikën grupeve serbe që bënin lëvizje si banorë të banesave kolektive, para të cilave shu-

mica absolute e veturave janë pa tabela regjistrimi.

Ali Kadriu, vëllai i dëshmorit dhe krijuesit poetik dhe të pikturës, Kadri Kadriu, që u masakrua nga serbët në mars të vitit 1999, thotë se këtu çdo gjë dihet e njihet dhe se nëse veturat e shqiptarëve do të qarkullonin pa tabela, menjëherë policia reagon, ndërsa kjo nuk vlen edhe për serbët!

“Po i shihni veturat pa tabela regjistrimi! Nëse shqiptarët qarkullojnë pa tabela menjëherë i ndalon policia, kurse për serbë kjo nuk vlen!

Unë jetoj këtu prej vitit 1987, që afro 30 vjet dhe të gjithë serbët që kanë jetuar këtu para luftimeve i njoh, por këta që kanë ardhur pas luftimeve nuk i njeh askush. Nuk dimë kah kanë ardhur apo kush janë, por dyshojmë se janë serbë të Kroacisë, që i kanë humbur atje mundësitë e jetesës pas luftës me kroatët.

Sidoqoftë, këta që kanë ardhur i ka sjellë Serbia, qeveria e Beogradit”, thotë Ali Kadriu dhe tutje vazhdon:

“Qeveria e Serbisë u qëndron afër serbëve, duke u dalë në ndihmë për çdo problem dhe duke i mbështetur me forcat e MUP-it. U ka ndërtuar banesa kolektive, duke e populluar lagjen “Kroi i Vitakut” me banorë të rinj serbë, që i përngjanë kolonizimit të vjetër të Kosovës.

Neve, shqiptarëve, nuk na ka dalë në ndihmë qeveria jonë, prandaj kemi mbetur nën mëshirën e fatit! Jemi duke bërë aq sa mundemi vetë...

Andaj, duke mos e pasur krahun e qeverisë sonë, serbët po e popullojnë lagjen pa asnjë dokument identiteti, ndërsa ne, shqiptarët, që i kemi pronat dhe trojet tona, nuk mund të ndërtojmë asgjë, sepse kontestohemi nga komuna, e udhëhequr nga Rakiqi!”

EDHE PSE I RRAHUR DISA HERË NGA SERBËT, NUK E LËSHON SHTËPINË!

Ali Kadriu, mbi kullën e tij, ka vënë flamurin kombëtar. Ai në vazhdim të bisedës tregon peripecitë e ndërtimit të shtëpisë së tij dhe të familjes së vëllait të masakruar, Kadri Kadriu.

Thotë se është rrahur disa herë nga serbët, por nuk e lëshon shtëpinë.

Dhe, duke shpalosur këto detaje, thotë: “Mua më kanë rrahur tri herë serbët dhe qëllimi i tyre ka qenë i qartë: të frikohem dhe të largohem prej këtu. Por, unë i gjallë nuk e lëshoj shtëpinë time! Do ta mbroj pragun e shtëpisë sime me çka të mundem...”

Para një kohe na vizitoi një delegacion yni, në krye me koordinatoren Ylber Hysa. Dhe, kur serbët hetuan se kishte ardhur



delegacioni ynë, na gjuajtën. Pjesëtarët e delegacionit ikën, duke kërcyer edhe nga kati i tretë i shtëpisë! Vetëm Ylber Hysa nuk iku. Qëndroi me mua.

Kam pasur presione të shumta për ta lëshuar shtëpinë dhe më janë ofruar edhe grupe të serbëve që kur e kanë parë se nuk po frikësohem më kanë ofruar shitjen e truallit. Për 12 ari truall më kanë ofruar 1 milion e 200 mijë euro, por unë u kam thënë se Serbia nuk ka para të ma paguajë shtëpinë e as tokën time...

Por, ndryshe nga unë, kanë vepruar shumë shqiptarë, të cilët i kanë shitur trojet dhe pronat, sepse për të qëndruar këtu nuk është dashur vetëm të jetosh, por edhe ta mbrosh idealin kombëtar e etnik.

Sidoqoftë, shumë shqiptarë i kanë shitur pronat e tyre dhe tash gjendja është gati 50:50, por diferenca është se Serbia po u ndërton banesa kolektive serbëve, ndërsa ne as që hetojmë se kemi ndokund qeveri tonën!

Shkurt e shqip: për ne askush nuk ka bërë asgjë! Vijnë të na vizitojnë vetëm kur kanë nevojë t'i votojmë!

E, sikur ta kishim pasur një qeveri aktive, me siguri, gjendja do të ishte ndryshe. Së pakut, do të kishim qëndruar të gjithë këtu e jo t'i kemi sot nja 30 shtëpi shqiptare në këtë pjesë dhe të mbesim nën pritjen e ardhjes së familjeve të tjera shqiptare... Më poshtë të gjitha janë shtëpi shqiptare. Ajo atje (bën me dorë në drejtim të një shtëpie) është shtëpia e Bajram Rexhepit. Ajo që e vlen të thuhet për qeverinë tonë është fakti se edhe ndihmat sociale na i kanë ndalur për shumë banorë që jetojnë këndeje, ndërsa Beogradi u jep sa mundet dhe u ndërton falas, duke i stimuluar të vijnë këtu sa më shumë serbë.

Ka këtu shtëpi serbe që dihet se mbajnë armë, armatim. Këtë e dinë botërisht të gjitha organet e sigurisë, por askush nuk ka ndërmarrë asgjë që të përfshihen serbët nën ligj”, ka pohuar në kullën e vet Ali Kadriu.

KFOR-I FRANCEZ DHE GJENDJA E SHQIPTARËVE NË VERIUN E KOSOVËS

Ali Kadriu e lë KFOR-in francez përgjegjës për mungesë sigurie në veriun e vendit. Ai thotë se qysh me fillimin e hyrjes së këtyre trupave ushtarake, shqiptarët u privuan nga e drejta e jetës së lirë në shtëpitë e tyre dhe sot është kjo gjendje që është. Serbët, sipas tij, kanë gëzuar dhe gëzojnë të drejtat edhe për kriminalitet, edhe për qarkullim të lirë në këtë pjesë me e pa targa regjistrimi, ndërsa shqiptarët nuk e kanë të drejtën as të ndërtojnë në pronat e tyre!

“Qeveritarët tanë e përmendin veriun e vendit vetëm për poenë politikë! Nuk bëhen punët e mëdha duke u pasuruar, por duke vënë rend ligjor që jeta e qytetarëve të rrjedh normalisht.

Unë nuk jam që serbët të mos ndërtojnë në pronat e tyre ata që i kanë pasur, por jam kundër ndërtimit pa asnjë lloj leje në pronat shqiptare dhe kundër pengesave që na i bëjnë ata çdo ditë kur ndërtojmë ne!

Jam në shtëpinë time dhe nuk e pengoj askënd të jetoj në pronën e tij. E kam ndërtuar kullën në mënyrë simbolike, i ka 80 frenxhi. Në simbolikë të 11 marsit i kam 11 frenxhi, 28 frenxhi në simbolikë të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit, pastaj janë shtatë ditët e javës dhe kështu me radhë...”, thotë Ali Kadriu, teksa thotë se shqiptarët e kësaj ane kanë nevojë për interesimin e shtetit tonë...

P. S. Ky shkrim është botuar në revistën tonë, “Kosovarja”, në nr. 4, 2015. Po e ribotojmë se ende është aktual pjesa Veriore e Kosovës, mbase edhe më shumë se kurrë deri më tash.

**Gani Dili
Safet Krivaça**



UNION BUSINESS
Albanisch & Deutsch

GËZUAR
VITIN E RI

2023



UB

UNION BUSINESS

Albanisch & Deutsch

UNION der albanischen und deutschen
Unternehmen in Deutschland e.V.

*Ju uron Festat e Fundvitit si dhe
Gëzuar Vitin e Ri 2023!*

*Shëndeti, gëzimet dhe sukseset
të ju përcjellin Ju dhe Familjet e
Juaja për shumë mote.*

Gëzuar!

★★★★★
BREZOVICA
 HOTEL & SPA



Januar 2023

JANUARY

S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

FEBRUARY

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28				

MARCH

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

APRIL

S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30						

MAY

S	M	T	W	T	F	S
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

JUNE

S	M	T	W	T	F	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	

JULY

S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

AUGUST

S	M	T	W	T	F	S
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

SEPTEMBER

S	M	T	W	T	F	S
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

OCTOBER

S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

NOVEMBER

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30		

DECEMBER

S	M	T	W	T	F	S
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						

Urime festat e fundvitit

+383 49 30 10 30 | +383 45 60 70 70
www.brezovichotel.com

★★★★★
Hotel Garden

GËZUAR

2023

*Urime festat
e fundvitit*

★★★★★
Hotel Garden

Hotel Garden: +383 45 71 71 77; Garden Downtown: +383 48 71 71 77;
Website: www.hotelgarden-ks.com; Instagram: [/garden_hotels](https://www.instagram.com/garden_hotels)

Shkrimtari dhe përkthyesi nga Suedia, anëtar i Kryesisë së Shoqatës së Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë “Papa Klementi XI Albani” në Suedi dhe nënkryetar i saj, Hamit Gurguri, këto ditë nga gjuha serbe në gjuhën shqipe ka përkthyer librin e autorit serb Dimitrije Mita Petroviq, me titullin në origjinal “Borbe u Toplici 1877 -1878” (“Luftimet në Toplicë 1877-1878”).

Ky libër, i lënë në dorëshkrim, pra i pabotuar dhe i botuar në vitin 1979 nga Arkivi i Serbisë, është interesant për secilin lexues, sepse në të autori në formë të një ditari të luftës paraqet momente e ngjarje të ndryshme e të shumta nga spastrimi etnik i trojeve të pastra shqiptare nga sot Serbia e Mesme dhe Jugore, veçanërisht nga krahina e Toplicës, pra, të pohuara nga një kronist serb, Dimitrije Mita Petroviq. Për këto ngjarje janë publikuar shumë e shumë studime nga historianët shqiptarë, turq, serbë e të tjerë dhe kështu janë ndriçuar të vërtetat historike.

Sipas disa të dhënave arkivale serbe, thuhet, mes të tjerash, se gjatë luftërave serbo-turke të viteve 1877-1878, ushtria serbe, duke zbatuar urdhrin e shtabit të përgjithshëm dhe qeverisë serbe, i shpërnguli me forcë nga Toplica, Leskovci, Nishi, Vranja më tepër se 300.000 shqiptarë.

Por, e vërteta është se prej kësaj krahine shqiptare me dhunë ushtarako-policore mbretëria serbe e Obrenoviqve dëboi rreth 830.000 shqiptarë etnikë. Kjo u realizua duke bërë një gjenocid dhe spastrim etnik total, kur janë vrarë e masakruar rreth 70.000 shqiptarë, të cilët banonin në afro



Si i dëbuam dhe vramë arnautët (shqiptarët) nga Nishi?

700 fshatra e qytete shqiptare vetëm në Krahinën e Toplicës.

Në këtë kohë janë zbrazur trojet me shumicë shqiptare të Jagodinës, Kosanicës, Pirotit, Çuprisë, Pllanës, Krushëcit, Nishit, Leskovcit, Surdulicës, Vranjës, Prokupjes, Kurshumlisë etj. Popullsia e shpërngulur shqiptare, e cila arriti t'i shpëtojë gjenocidit serb, u vendos në jug të trojeve shqiptare në Kosovë dhe në Maqedoni. Këta shqiptarë sot e asaj dite janë të njohur dhe të quajtur muhaxhirë (refugjatë). Madje, shumë prej tyre sot e asaj dite, si mbiemër, e mbajnë emrin e fshatit ose trevës prej nga janë dëbuar. Kronisti serb Dimitrije Mita Petroviq ishte edhe vetë pjesëtar i ngjarjeve të sipërme.

Ai në këtë libër të lënë në dorëshkrim jep lloj-lloj skenash e detajesh për gjenocidin dhe zullumin e ushtuar ushtarakisht mbi burra, gra e fëmijë të arnautëve, siç i quan ai shqiptarët, vuajtjet e arnautëve për shkak të gjenocidit të ushtuar mbi ta, vjellvrrer e urrejtje ndaj tyre, tregon për djegiet e shtëpive të arnautëve, për uzurpimin dhe plaçkitjet e pasurive të tyre, vrasjet, spastrimet etnike, prerje kokash, ekzekutime, uri etj. Por, njëkohësisht, pohon edhe për

rezistencën e organizuar dhe individuale si dhe për shpirtin luftarak të arnautëve, trimërinë e tyre të treguar në fushat e betejave.

Pra, në këtë libër rrëfëhet edhe për rezistencën e fortë të arnautëve me shumë sakrifica, flijime dhe heroizma. Shënimet, të cilat i ruajti autori, ua la amanet fëmijëve. Kështu, e bija e tij, Lubica Llukoviqi (emri i vajzërisë Petrovqi), në vitin 1977, e vetmja trashëguese e gjallë, atë vit 92-vjeçare ia dhuroi të gjitha shënimet e të atit Arkivit të Serbisë, me kusht që ato të botoheshin.

Ky libër është një ndër shënime të pakta, të cilat flasin për spastrimin etnik të Krahinës së Toplicës, të Nishit dhe të Pirotit nga banorët shqiptarë, numri i saktë i të vrarëve dhe të shpërngulurve nuk u përcaktua as nuk u vërtetua kurrë.

Shpërngulje, shpronësim e shfarosje ishte moto e luftës për Toplicë, e cila, për ironi, ende sot në historinë serbe e quajnë luftë çlirimtare, ani se ishte zaptuese dhe me pasoja shumë tragjike për disa breza muhaxhirësh shqiptarë të këtyre viseve, pasardhës i të cilëve është edhe përkthyesi i këtij libri.

ASSBAU 



GËZUAR
2023



Po të martoheshit sivjet, kë nga politikanët tanë do e thërrisnit në dasmë?

Politikanët gjithmonë janë temë diskutimi, qoftë për të mirë qoftë për të keq. Këtë herë bëme një anketë me disa të rinj nga Prishtina në temën: Po të martoheshit sivjet, kë nga politikanët tanë do e thërrisnit në dasmë?

**VERIME IDRIZI, STUDENTE:
HASHIM THAÇI DO
E MBANTE BAJRAKUN!**

- Po të martohesha sivjet, me dëshirë do e thërrisja në dasmë Hashim Thaçin. Por, ai ndodhet në Hagë dhe dëshira nuk mund t'më realizohet.

Pse do e thërrisja? Sepse, njeri pas Rugovës, i cili ka bërë më së shumti për Kosovën, është Hashim Thaçi dhe atij i takon ta mbajë bajrakun.

Ndërkaq, nga femrat do e thërrisja deputeten e LDK-së Hykmete Bajramin, sepse e meriton të jetë e para në valle, si për mençuri ashtu edhe për trimëri e guximin që ka.

**VULLNET EMINI, KAMERIER:
ISA MUSTAFËN
DO E QITJA NË BALLË
TË OXHAKUT!**

- Sivjet nuk e kam në plan të martohem, a vitin tjetër me kësmet po.

E, se kë do e thërrisja në dasmë nga politikanët tanë është punë e lehtë: Isa Mustafën do e qitja në ballë të oxhakut, sepse edhe me moshë i takon të jetë në krye. Pas tij do e thërrisja Albin Kurtin, por zor se do të vinte, meqë është Isa Mustafa në ballë të oxhakut e ai ka dëshirë të jetë vetë në atë vend!

**VIGJILENTE ELMAZI,
FARMACISTE:
KRUSHKA IME E PARË –
BLERTA DELIU**

- Krushka ime e parë kisha pasur dëshirë të ishte deputetja Blerta Deliu.

Pse? Sepse e zonja sa të duash, oratore dhe e arsyeshme po, e bukur po, veshje me stil po.

Ndërkaq, nga politikanët meshkuj do kisha pasur dëshirë ta kisha në dasmë Lutfi Hazirin, sepse nëpër debate po është shumë i qetë dhe i arsyeshëm. E, një i tillë si ai do dinte të mbante fjalime si duhet dhe si e lyp vendi.

Por, edhe Glauk Konjufcën kisha pasur dëshirë ta kisha në dasmë, sepse, si kryetar i Kuvendit, do dinte t'u printe krushqve...

PËRFUNDIM

Dashtë Zoti të anketuarit tanë të martohen sa më shpejt dhe t'i kenë në dasmë të dëshiruarit e tyre, në mënyrë që dasma e tyre të jetë sa më madhështore...

Diturie Haxhaj

Suanita

HIGH END LUXURY



Gëzuar Fëstat

SUANITA High End Luxury ofron produkte ekskluzive dhe unike nga të gjitha markat luksoze !

Parimi ynë mund të përkufizohet si:

MË E MIRA PËR MË PAK: Gjithmonë ofrojmë cilësinë më të mirë për çmimin më të mirë.

CILËSI E GARANTUAR: Ofrojmë veçm produkte të cilësisë më të lartë, premium në çdo detaj (imiim i klases së parë !)

📍 rr.Ferid Curri, Arbëri - Prishtinë

📷 suanita_highendluxury

🌐 www.suanitashop.com



 **lanaderm**

2023

January

S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

February

S	M	T	W	T	F	S
		1	2	3	4	
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28				

March

S	M	T	W	T	F	S
		1	2	3	4	
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

April

S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30						

May

S	M	T	W	T	F	S
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

June

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	

July

S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

August

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

September

S	M	T	W	T	F	S
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

October

S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

November

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30		

December

S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

Gëzuar Festat e Fundvitit



MARITIM
Resort Marina Bay

Një tjetër vit erdhi më në fund!

Familja jonë e madhe është gati të nis pa frikë sfidat si dhe të mbaj fort kujtimet e bukura që ka kaluar me çdonjërin nga ju.

Gëzuar 2023!

+355 69 604 1000 - +355 33 41 0000
www.marinabay.al - info@marinabay.al
Aleksandër Moisiu, Vlorë, Shqipëri 9405

Serbët ia vranë gruan dhe 7 fëmijë!

Në çdo 28 nëntor, në ditën e Flamurit Kombëtar, Isak Asllani, nga fshati Rancë i komunës së Shtimes, veteran dhe invalid i luftës së UÇK-së, merr rrugën që çon te varrezat...

Aty ku shkon Isaku nuk janë varrezat e fshatit, ashtu siç rëndom i hasim gjithandej e ku njerëz të ndryshëm shkojnë e ndajnë dhimbjen për humbjen e më të dashurve të tyre. Janë varret e nënës, gruas dhe shtatë fëmijëve të Isakut, të cilët, bashkë me mbesën dhe gruan e

vëllait, u vranë në gusht të vitit 1998 nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë. Këtu s'ke se si ta ndash dhimbjen, ajo vjen si një uragan dhe përplasjet furishëm në shpirtin dhe zemrën e Isakut, duke e dërmuar atë që prej dy dekadash. Isaku mundohet që përmes prekjes së shkronjave ta ledhatojë fytyrën e djalit, Burimit, që atë botë ishte vetëm 13 vjeç, pastaj Lumnijes, Ejupit, Luljetës, Shpendit, Xhaferit dhe Antigones së vogël, që sapo kishte mbushur 1 vit kur u vra nga forcat serbe. Isaku gjatë luftës shkon për t'i dalë në ndihmë familjes, e cila ndodhej në zjarr të luftës. Shkon bashkë me të vëllanë, Musën. Por, në ato çaste forcat serbe me tank kanë gjuajtur në drejtim të tyre dhe Isaku e Musa janë plagosur. Pastaj, Isaku ishte tërhequr me ndihmën e ushtarëve të UÇK-së dhe ishte shtrirë në spital për shërim, por familja i ishte copëtuar dhe masakruar nga granatat e forcave serbe.

E, edhe Ekremi, vëllai tjetër, ishte plagosur, duke u mundur t'u dalë në ndihmë familjes. Kështu, e tërë familja pësojnë. "Mungesa për ta është e madhe, por edhe krenaria për ta është, gjithashtu, e madhe, sepse kanë dhanë jetën për këtë tokë", thotë veterani i luftës. Isaku, sidoqoftë, edhe pse armiku ia kishte vranë gjithë familjen, ai përsëri gjeti forcë dhe arsye për të vazhduar jetën... Dhe, pas 20 vjetësh të masakrës që i bën serbët familjes së tij, ai, në moshën 60-vjeçare, në përpjekje për të pasur një trashëgimtar, më në fund, i buzëqeshë fati dhe shpërblehet me një mrekulli, e ku, në fakt, janë dy. "Perëndia m'i ka sjellë në jetë dy fëmijë binjakë, vajzën (Lumnijen) dhe djalin (Ejupin) me gruan që jam martuar. I kam përtëri emrat e fëmijëve të parë", tregon Isak Asllani, nga fshati Rancë i komunës së Shtimes.



"F.M Fashiongate" zgjedhja e vetme për femrat që dëshirojnë të shkëlqejnë për festat e fundrit!

/fm_fashiongate



S'kam lënë gjë pa bërë, e i dashuri më tha: **A martohe- mi?**

*Tri orë ia tregova të dashurit të kaluarën time zi e më zi. E ai, pasi u mendua, më shikoi drejt në sy dhe më tha: "A martohe-
mi?"*

Qëkur isha 16 vjeçe, në klasën e tetë të shkollës fillore, u dashurova në një bashkëvendas timin dhe pas një kohe të shkurtër jam fejuar e jam martuar ende pa i mbushur 17 vjet.

BURRI IM LUANTE ME TOP, E UNË E PRISJA NË SHTËPI!

Por, vetëm kur u martova nisën problemet me burrë, sepse si të ri nuk dinim mirë as ç'ishte martesë.

Ai me shokë luante top dhe harronte se gruan e kishte lënë në shtëpi... Ma ndaloi shkollimin në gjimnaz dhe me atë veprim edhe e shkatërroi jetën time... Dhe, pas disa muaj jete të vështirë, duke jetuar në një shtëpi si në burg, e pas shumë maltretimeve nga burri dhe vjehrra, vendosa me i dhënë fund martesës 7 muajsh. Fatmirësisht, familja më përkrahu dhe më doli në ndihmë. Madje, iu ktheva edhe shkollimit. E kreuva shkollën e mesme dhe fakultetin e edukimit.

A TË LËSHOI ZOTI NGA QIELLI, A?!

Tash, e që i kam kaluar të 25-at, deshi Zoti e u punësova në njërin nga ministratë tona, në një vend të mirë pune. Dhe, pas nja dy muaj punë, u njoha me një djalë 10 vjet më i vjetër se unë, e që edhe ai punonte po në të njëjtën ministri. Në fillim pinim kafe në bufenë e ministrisë si kolegë. Por, pas një kohe filluan të shpeshtoheshin takimet tona dhe një ditë më ftoi të dilnim për drekë jashtë

ministrisë.

Dhe, teksa drekonim, nuk m'i shkoqte sytë. Në një moment më tha: "Ishte ëndërr imja ta takoja një femër si ti! A të lëshoi Zoti nga qielli, a?!"

Në atë moment nuk i thashë gjë. Ngurrova t'i tregoja për të kaluarën time. Sidoqoftë, kontaktet tona vazhdonin... Kafetë bashkë vazhdonim t'i pinim. Por, një ditë, në kohën e pauzës, i tregova historinë time fill e për pe... Pastaj, heshta unë, por heshti edhe ai... Vetëm shikoheshim ndërmjet veti, pa nxjerrë fjalë nga goja...

E, veç kur u bëra gati t'i them që të ngrihem e të shkojmë në vendet e punës, ma rroku dorën, më shikoi gjatë në sy dhe më tha: "A martohe mi?"

U shtanga. Mbeta pa tekst. Mbeta pa fjalë. "Hë? Nuk do të martoheh me mua, a?", më tha edhe një herë.

"Dua të martoheh. Me kënaqësi, madje. Por, a nuk të pengon e kaluara ime, a?", ia ktheva.

"Jam dashuruar në ty, e jo në të kaluarën tënde!", ma ktheu.


E. Selmani



*Mimoza
Demiri*

HAPPY
New
YEAR

 /bigmozz_

 /@mimoza.demiri

Në cilin katund shpirtrat e vdekur trokisnin në dritare?

Të dy vajzat e vdekura, me veshje të bardhë, shfaqeshin në dritaren e kullës në një fshat të Anadrinit. Kërkonin të hynin brenda kullës prej guri...

Në kullën e gurtë buzë malit, shpirtrat e vdekur vinin te të gjallët. Gojëdhëna thotë se i Zoti i kullës e kishte pasur gruan dhe dy vajza. Ishte tregtar i pasur.

Një ditë, për përfitime tregtie, i kishte lënë vajzat dhe gruan në kullën buzë malit, rreth së cilës gjarpëronte lumi me ujë të kthjellët dhe kishte marrë rrugën për në Rozhajë, meqë merrej me tregti.

Andaj, shërbëtorja, kur vëren se zotëria nuk ndodhej me ditë të tëra në shtëpi, në ushqim u hedhë helm vajzave dhe gruas së pasanikut.

Qëllimi i shërbëtores nuk ishte vjedhja e pasurisë së zotërisë, por martesë me pasanikut, sepse ishte dashuruar në të që nga dita e parë kur kishte ardhur të punojë në atë shtëpi.

Dhe, pas një muaji, kur kthehet pasaniku në shtëpi me kuajt ngarkuar me ar e argjend, shërbëtorja i thotë se pas shkuarjes së tij kusarët e kanë sulmuar shtëpinë dhe ia kanë vrarë gruan dhe vajzat, ndërkaq ajo kishte shpëtuar duke arritur të ikë në mal.

Pasaniku dëshpërohet rëndë dhe tenton të bëjë vetëvrasje, por shërbëtorja arrin ta shpëtojë.

Dhe, pas një viti të asaj ndodhe, shërbëtorja i bie në gjunjë dhe e lutë që ta marrë për grua.

Por, dita-ditës shërbëtoren e rroku një shqetësim i madh, sepse e mundonte krimi që kishte bërë në atë familje...

SHPIRTRAT E VDEKUR TROKISNIN NË DRITARE!

“Shërbëtorja”, tashmë nuse e pasanikut, teksa kishte rënë me fjetur, në dritare dëgjon një trokitje të pandërprerë. Ajo mendon se është burri i saj, pasaniku, sepse i kishte dy ditë që nuk ishte në shtëpi.

Kur iu afrua dritares, pa vajzën e dytë të padronit që e kishte helmuar! Mendoj se ishte në ëndërr dhe i fshiu sytë fort. Por, sërish sheh fytyrën dhe trupin e saj. Ajo donte të futej brenda, ndërkohë jashtë binte borë e madhe.

Në çast, hija e vajzës largohet nga dritarja, e ajo me frikë të madhe në shpirt kthehet në shtrat, por assesi nuk e zinte gjumi...

NATA E DYTË E SHFAQJES SË SHPIRTRAVE TË VDEKUR!

Një muaj më vonë, kur pasaniku sërish nuk ndodhej në shtëpi, i përsëritet po e njëjta pamje, por këtë herë nuk ishte vetëm vajza e madhe, si herën e parë, por ishin të dy vajzat bashkë... Këtë herë i dëgjoji edhe zërat e tyre...

Sërish e përfshijnë valë djersësh dhe zemra desh i del nga vendi nga frika e madhe.

Mbi të gjitha, e brente ndërgjegjja se ajo ishte shkaktare e vdekjes së tyre...

NATA E TRETË E SHFAQJES SË SHPIRTRAVE TË VDEKUR!

Disa muaj më vonë, e që këtë herë burrin e kishte në shtrat, në gjumë, "shërbëtorja" i dëgjon trokitjet e radhës në dritare. Ethet e frikës e kapin përsëri, por nuk kishte guxim ta thërriste zotërinë, sepse frikësohej mos ata zëra që vinin nga jashtë do flasin se ajo i ka helmuar. Dhe, pas një kohe, për çudi, hijet dhe zërat pushuan, por brenga e "shërbëtores" se vajzat e burrit do të shfaqen sërish nuk e linte të bënte jetë të qetë...

S. Murturi



A janë mëkat fëmijët e lindur në laborator?

Jam nënë e shtatë fëmijëve. Por, ma lexoi njëra prej mbesave të mia një shkrim që tregon se si mund të blihen sot fëmijët për 100 mijë euro dhe ata qenkan fëmijë të laboratorit! A është mëkat dhe çka ka këtu të vërtetë?

Hisnije Iseni, Gostivar

Bota po ecë me hapa të shpejtë në zbulime domethënëse, e edhe në prodhimin e fëmijëve në laborator. Është prodhuar tashmë laboratorit që quhet "Ectolife" dhe që lind fëmijë laboratorik, bazuar në klonim.

Një fëmijë i tillë, sipas informacioneve të para që posedon bota, do të kushtojë 100 mijë euro...

Fëmija laboratorik, megjithatë, ka ngritur qindra pyetje për prodhuesin:

A do e ketë ai fëmijë ndjesinë e një fëmije si ai i zhvilluar në mitrën e nënës, e cila gjatë shtatzënisë gëzohet e hidhërohet, qanë e qeshë?

Te fëmija laboratorik të gjitha këto ndjenja janë të munguara, sepse inkubatori laboratorik është aparat pa ndjenja dhe pa përjetime.

Fëmijët laboratorikë nuk kalojnë nëpër procese të mitrës së një nëne, e cila ushqen fëmijën nga materia biologjike, por artificiale. Prandaj, nisur nga logjika dhe studimet e shumta të kësaj natyre, fëmija nga inkubatori nuk do i posedojë të gjitha ndjenjat e njeriut të deritashëm biologjik.



remos®

2023

Köln
Aachener Str. 21
50674 Köln

Frankfurt
Ulmenstr. 30
60325 Frankfurt

Koblenz
Bahnhofplatz 5
56068 Koblenz

Wiesbaden
Langgasse 36
65183 Wiesbaden

Urmitz
Rudolf-Diesel-Str. 19
56220 Urmitz

Oberhonnefeld
Westerwaldpark 4
56587 Oberhonnefeld

Wishing you a wonderful

NEW YEAR

to you and your family





FEMRAT
e arta





Rrugëtimi i suksesshëm **i Shkenda Dubovës**

Emri i saj është shndërrua në patentë të famshme, tashmë edhe ndërkombëtare, pasi Qendrat e Dobësimit, me emër e mbiemër personal, gjenden kudo brenda dhe jashtë kufijve. Shkenda Dubova, nga një këngëtare atraktive e shumë e dashur për publikun, është shndërruar në një nga emrat më të afirmuar të fushës së biznesit. E cilësuar si femër e artë, Shkenda Dubova prej vitesh është në top-listën e afaristeve të sukseshme në vend, e kjo falë rrjetit të qendrave të dobësimit që mbajnë emrin e saj. Qendrat profesionale për dobësim të Shkenda Dubovës, prej vitesh janë shndërruar në shpresën e madhe për personat mbipeshë. Siç dihet, qendrat e dobësimit gjenden në shumë nga qytet e Kosovës, në Diasporë dhe në vitin 2023 Shkenda dhe koncepti i saj, më efikasi për humbjen e peshës së tepërt trupore, do të jenë edhe në Amerikë. Ndryshe, në Qendrat për Dobësim Shkenda Dubova punohet me programe të veçanta dhe aparaturën më të re e më të sofistikuar në botë. Suksesi i Shkenda Dubovës në fushën e biznesit po shërben si motiv për shumë femra shqiptare anë e kënd botës. Shkenda nuk ndalet, andaj mbetet të shihet se ku e si do të rrugëtojë në vitin 2023...



29

**Shkenda
Dubova**



Arbnora Ademaj *e bukura e Kosovës*

Një ditë dikush shkoi në shkollën e saj dhe i tha se mund të merrte pjesë në garën “Miss Peja”, meqë është e gjatë dhe e bukur.

Dhe, më shumë se njëmijë mendime iu sollën në kokë: të shkoj a të mos shkoj...

Sidoqoftë, pranoi, pa e ditur se mu ai eveniment do ta ndryshonte jetën e saj, do ta bënte një nga emrat më të njohur të bukurisë e spektaklit, madje jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë.

Dhe, jo rastësisht thonë se rasti është mbret i botës, e këtë e dëshmon më së miri historia e Arbnora Ademaj, bukuroshes me shumë kurora...

Arbnora fitoi kurorën “Miss Peja”, “Miss Kosova”, “Miss Globe International”, e shumë të tjera me rëndësi.

Vite me radhë punoi në fushën e biznesit, si afariste e zonja, por edhe në televizion me projekte mjaft interesante.

Se Arbnora është “vajzë e befasive”, këtë e tregoi edhe pjesëmarrja e saj në botën e kinematografisë turke, ku deri më tani ka qenë pjesë e disa projekteve. Modelja, tashmë edhe aktorja e njohur Arbnora Ademaj, ka shkëlqyer në serialin turk “Kirik Hayatlar” (“Jeta e thyer”), ndërkohë që ka nisur xhirimet për një serial tjetër, e që do të shfaqet në “Netflix”.

Ylli i ekranit, Arbnora Ademaj, sapo ka lënë pas një eksperiencë interesante, atë në “Dance with me” në Tiranë, për çka është përfolur gjatë.

Andaj, edhe viti 2022 ishte i bujshëm për të bukurën e Kosovës, e akoma më me “hallakamë” duket se do të jetë viti që po vjen...



31

**Arbnora
Ademaj**



NORIK UKA

Një emër: Yllka Kuqi

Kur flitet për këngëtaret e mëdha të skenës sonë muzikore, Yllka Kuqi, pa dyshim, është në listën e më të mirave.

Emri i Yllka Kuqit është ndër më familjarët për publikun shqiptar, e kjo falë zërit, imazhit dhe karakterit unik që ka. Yllka është ndër këngëtaret e rralla që ka bërë "boom" që me paraqitjen e parë në skenë, me potencialin e madh dhe ngjyrën karakteristike të zërit, me shtrirje të gjerë të vokalit.

Për të muzika është një nocion shumë i gjerë, e që nuk mund ta përmbledhë me pak fjalë...

Në çdo kohë, në çdo çast dhe në çdo gjendje ajo ka dëshirë të shoqërohet nga muzika dhe të këndojë, pasi këndimi i vjen nga thellësia e shpirtit.

Kënga, sipas Yllkës, ia jep mundësinë ta shpалosë shpirtin e saj artistik dhe t'i falet asaj... Yllka ka marrë pjesë në "Polifest 2004", me këngën "Ti je ai", ku edhe u nderua me çmimin e parë.

Dhe, kjo këngë u bë trampolinë suksesi për të.

Sidoqoftë, këngëtares nuk i munguan asnjëherë paraqitjet në skena të mëdha festivalesh, ku gjithmonë u nderua me çmime të merituarra, ndërkohë që ndërtoi një karrierë brilante me këngë e videoklipe moderne. Sot, pa dyshim, Yllka Kuqi është një nga më të kërkuarat e më të dashurat nga publiku i gjerë.

Yllka është nënë e lumtur e një vajze dhe gjithmonë e komentuar për bukurinë e saj të mrekullueshme.



33

NORIK UKA

**Yllka
Kuqi**



Si e bëri
Mimoza Bullatovci
butikun “Fortesa”
më të njohurin në Kosovë?

Mimoza Bullatovci është emër i njohur në botën e biznesit, meqë është pronare e njërit prej butikëve më të njohur dhe më të frekuentuar në vend, Butikun “Fortesa” në Prishtinë, ku femrat bëjnë zgjidhje me të parën.

Është butiku luksoz më i vizituari në kryeqytet dhe jo vetëm, që për vite me radhë ka krijuar një klientelë të gjerë e tejet të kënaqur dhe kjo falë mallit unik, cilësor e të jashtëzakonshëm.

Mimoza është vetë formula e suksesit për biznesin e saj të njohur. Ajo ka bërë më të mirën, duke vënë në jetë vizionin dhe shijen e saj të veçantë.

Pra, është një grua, e cila arrin t'i bëjë të gjitha njëkohësisht dhe ta ruajë reflektimin pozitiv, buzëqeshjen dhe të duket përherë mahnitëse.

Mimoza Bullatovci shpesh komentohet për pamjen e saj, bukurinë dhe finesën që e karakterizon.

Përtej kësaj, ajo është një “businesswomen”, që e di saktë se çfarë duhet të bëjë, që puna të ecë mirë dhe që “Fortesa” të jetë adresa e mijëra femrave që duan të shkëlqejnë.

Ndryshe, Butiku “Fortesa” është më i vizituari edhe nga fytyrat publike.



35

**Mimozza
Bullatovci**



Liza Gjini, maestroja me 20 vjet suksese

Liza Gjini, profesioniste e dëshmuar në fushën e bukurisë dhe estetikës, zonjë e cila ka investuar shumë në vete që të jetë kjo që është sot, maestro në profesionin e saj.

Liza, grua e fortë dhe e pandalshme në rrugën e suksesit, një ëndërrimtare e kahershme, e cila ka ditur që ëndrrat e saj t'i bëjë realitet.

Liza cilësohet si më e mira e zanatit, pronare e qendrës së famshme të bukurisë "Teuta Beauty Center" në Gjakovë.

Në sallonin e saj të mirënjohur ofrojnë shërbime të ndryshme, duke nisur nga shkurtimi i flokëve, fenerimi, ngjyrosja, shatiret ose ombret, grimi, ngjitja e flokëve, frizurat, mbjellja e thonjve, tretmani me fije kolagjeni, pastrimet e fytyrës, realizimi i vetullave microblading etj.

Liza tregon se ndihet shumë e lumtur për të arriturat në fushën e bukurisë. "Jam shumë e lumtur kur i shoh të arriturat e mija profesionale. Besoj që secili nga ne, kur vendosim të punojmë fort për qëllimet tona, ia dalim.

Gjatë rrugëtimit tim 20-vjeçar, shpesh i kam imagjinuar ditët që i jetoj sot dhe jam mjaft falënderuese se ëndrrat më janë bërë realitet", thotë Liza, duke shtuar se mundohet që secilën grua ta ndihmojë, së paku, të ketë mendime pozitive, por edhe në anën profesionale, ku është përherë e gatshme t'i aftësojë ato që duan të profesionalizohen në fushën e saj.

Liza tregon se viti i sivjetmë ka qenë i suksesshëm, madje përtej parashikimeve të saj, për çka ndihet e realizuar dhe i falënderohet Zotit.

Gjatë vitit 2022, në sallonin "Teuta Beauty Center", nisi shërbimi i kolagjenit në fytyrë, që këtë sallon e bëri tejet të frekuentuar për shkak të efektshmërisë së këtij shërbimi ekskluziv.

Liza uron për vitin 2023 shëndet e më të mirat në jetë.



37

**Liza
Gjini**



Fitore Haliti zbulon çelësin e suksesit

Fitore Robelli-Haliti jeton e punon prej vitesh në Zvicër. Fitorja ka arritur t'i realizojë qëllimet, të jetë e suksesshme dhe të realizohet në të gjitha aspektet dhe dimensionet.

Fitore Haliti që disa vjet e ka hapur salonin e saj të bukurisë dhe kozmetikës "Fitore's beautyhome", tashmë mjaft i njohur në Zvicër, në kantonin e Cyrihut. Arsyeja se përse Fitorja ia ka dalë të ketë sukses e një klientelë të kënaqur, është cilësia e lartë në shërbimet që ofron. "Unë punoj me vetulla Microblading (vetulla me fije), Permanent Make Up, pastaj i kryej të gjitha shërbimet me Filler (Hyaluron), Laser (fshirja e tatove të vjetër), Microneedling dhe shumë shërbime të tjera të kozmetikës", thotë për revistën tonë, "Kosovarja".

Tutje shton se është ndjenjë shumë e mirë kur e sheh se munda po të shpërblehet.

"Kam punuar shumë për të arritur deri në këtë pikë dhe jam tejet e lumtur që munda i të gjitha viteve po më shpërblehet".

Fitorja tregon se qysh në vegjëli e ka pasur pasion fushën e kozmetikës, modës e dizajnit, por nuk ka menduar se një ditë do të mund ta bëjë ëndrrën realitet e të jetë kjo që është.

Në fakt, Fitorja ia ka dalë bindshëm dhe sot është një shembull real se si me punë dhe angazhim arrihet gjithçka.

Tregon se viti i sivjetmë ishte i mbarë, por ajo është kërkuese, andaj ka ambicie edhe më të mëdha.

"Pa dyshim, nuk ndalem në rrugën e suksesit. Unë mendoj se sekretin e të arriturave qëndron te pozitiviteti dhe dashuria për punën.

Jam e lumtur që, krahas të arriturave profesionale, sivjet kemi pasur edhe shëndet të mirë".

Fitore Haliti, që është grua e zonja dhe bashkëshorte e nënë e dedikuar, i uron të gjitha gratë për suksese e mbarësi në vitin 2023.



39

Fitore's Beautyhome



**Fitore
Haliti**



Lindita Emerllahu-Linda, *e famshmjia e fushës së bukurisë dhe estetikës*

Njerëzit e kanë të freskët historinë e rrëfyer në “Kosovare” të Lindita Emerllahut, zonjës me 20 diploma nga fusha e bukurisë dhe estetikës.

Lindita është histori e gjallë suksesi, një profesioniste që ia del gjithmonë për ta bërë më të mirën në fushën e së bukurës dhe në ngritjen e biznesit të saj.

Ajo njihet për punën e shkëlqyer që bën në fushën e parukerisë, për markën e saj të flokëve “Linda hair extensions” dhe shërbitimet ekskluzive estetike që ofron në sallonin e saj “Linda coiffure et esthétique” në Gjenevë të Zvicrës.

Edhe viti 2022 ishte i suksesshëm për të... “Çdo njeri ka ëndrra në jetë. Por, për t’i realizuar duhet kohë, punë dhe sakrificë dhe jam krenare me veten time dhe të arriturat e mija edhe gjatë këtij viti. Në fakt, gjithmonë kam ëndërruar që një ditë të jem kjo që jam sot”.

Linda thekson se të gjitha njohuritë e saj që i ka në fushën e bukurisë mundohet t’i transferojë edhe te të tjerët, të cilët janë të interesuar në këtë fushë. Linda, nga “Linda coiffure et esthétique”, thotë se njeriu duhet ta kërkojë gjithmonë suksesin, ndërkohë që tregon se ajo është vazhdimisht duke punuar për të sjellë risi në sallonin e saj, i cili tashmë vizitohet edhe nga kliente nga e gjithë bota.

Linda uron që viti 2023 të jetë vit i realizimit të ëndrrave dhe të shëndetit të mirë për të gjithë.



41

**Lindita
Emerllahu
-Linda**



Vera Qollaku, shembull i shkëlqyer për gratë e Diasporës

Vera Qollaku është emër i njohur, meqë salloni i saj “Beautynailsvera.ch” në Zvicër është tejet i frekuentuar.

Zonja e suksesshme e fushës së bukurisë, që kryen shumë shërbime profesionale me pasion, dashuri dhe delikatesë të madhe, kishte një vit mjaft të bujshëm në aspektin profesional.

“Beautynailsvera.ch”, që është brendi dhe firma e saj me emër në Zvicër, i ka tejkaluar pritshmëritë e Verës.

“Të jem e singertë, asnjëherë nuk kam menduar se jam kaq shumë e suksesshme sa jam, por këtë gjë ma kumtojnë klientet e mija, të kënaqura e të lumtura me shërbimet që marrin në sallonin tonë.

Kjo nuk është, thjesht, punë, por edhe pasion për mua”.

Vera shton se viti 2022 ka qenë i suksesshëm dhe nuk është ndalur së bëri më të mirën edhe me kursantet, të cilat avancohen në nivel fillestar dhe të avancuar për thonj dhe qerpikë.

Vera Qollaku sivjet ka marrë një master class për qerpikë, për çka është mjaft e lumtur.

Për “Kosovaren” thotë se nuk ka ndonjë peng që i ka mbetur gjatë vitit 2022.

Po, cili ishte çelësi i suksesit për të?

“Dashuria, të bërit e gjërave me përkushtim dhe pasion, janë çelësi për të qenë të suksesshëm e të lumtur”.

Vera uron me zemër që të gjithë njerëzit t'i bëjnë ëndrrat e tyre realitet në vitin 2023.





43



**Vera
Qollaku**



Anita Muja është femër e artë, e fortë, profesioniste e zonja dhe bashkëshorte e nënë e dedikuar. Sepse, ata që e njohin, listën e komplimenteve për të e kanë të gjatë...

Doktoresha e njohur e dermatologjisë dhe estetikës ka bërë që, falë profesionalizimit dhe etikes në punë, të jetë më e kërkuara.

Klinika "Anaderm" mbetet edhe më tej porta e madhe ku trokasin ata që duan të kenë lëkurë të shëndetshme, shkëlqyese, duan që pamjes së jashtme t'i japin notën e perfeksionit.

E, pa dyshim, gama e shërbimeve mjekësore dhe estetike në "Anaderm" është e gjatë. Në krye të klinikes më të njohur në Kosovë dhe rajon është Dr. Anita Muja, dermatologia estetike më e njohur, që gjen zgjidhje për shumë probleme dermatologjike dhe estetike.

Andaj, Dr. Anita, që është sinonim i profesionalizimit, por edhe i elegancës e bukurisë, sot është shndërruar në një nga emrat më të afirmuar të kësaj fushe.

Anita Muja

doktoresha e artë



45



**Anita
Muja**

Secili varr ka histori në vete...

Një varr i gjatë, i rrafshuar dhe i mbushur bar, me dy gurë: një te koka e tjetri te këmbët, më zgjoi kureshtjen kur hyra në varreza t'i vizitoja prindërit.

Një ëndërr disa net radhazi nuk më largohej nga mendja. Në ëndërr i shihja prindërit, që kanë vdekur që moti. Në natën e tretë e pashë babanë dhe nënën në një tren, tek udhëtonin, e që hekurudha vende-vende kalonte mbi ujë të kthjellët.

Dhe, të nesërmen, posa dola nga puna, bleva një tufë lule dhe u nisa me veturë për te varret e tyre. Por, në rrugë e hasa tim bir, që me moshë është i ri, dhe u ndala ta merrja me vete.

"Janë varret e prindërve të tu, a?", më pyeti posa iu afruam dy varreve.

"Po, por nuk janë vetëm varre!", i thashë.

"E, çka tjetër?!", ma ktheu.

"Në secilin varr ndodhen eshtrat e dikujt që ka jetuar dikur. Edhe ata kanë jetuar si ne sot. Edhe ata kanë ardhur t'i vizitojnë të afërmit e tyre. Kanë pasur mall për prindërit dhe të afërmit e tyre. Por, tash ndodhen në këtë vend, sepse nuk janë më në jetë. Andaj, edhe ne një ditë do të bëhemi banorë

të këtij vendi, në varre të përjetshme", i thashë.

VARRI MË I GJATË NGA TË TJERËT

Pasi pushon pak dialogu ynë për jetën e këtyre trupave që pushojnë në varre, ai shikon anash. Dhe, kur i sheh dy gurë që rrinin karshi njëri-tjetrit, më thotë:

"A thua, të kujt janë?"

"Varri i gjyshit tim është", i them.

"Po, gurtë po shihen, por varri jo!", ma ktheu.

Varri i tij është rrafshuar nga koha, vjetërsia, ka marrë pamjen e livadhit. Por, gurtë nuk kanë lëvizur.

PASHA TË RITË!

Xha Bajra, kur bënte be, thoshte "pasha të ritë"! Demek, betohej në kohën e rinisë. Pra, porosia e tij ishte ta kujtonim kohën e rinisë, që më nuk rikthehej.

Xha Bajrën ma kujtoi varri i tij në ditën

kur shkova t'i vizitoja prindërit në varreza. Ka qenë burrë i gjatë, i fortë. Kishte luftuar krah Ballit Kombëtar kundër partizanëve.

Dhe, me të mbaruar lufta, kishte punuar minator në Kishnicë deri në moshë të shtyrë.

E, edhe varrin e tij e pashë atë ditë kur isha në varreza...

Nostalgjia për llambën me vajguri. Këto ditë, teksa pinim kafënë e mëngjesit në kafenenë që ne e quajmë "Kafeneja në katin e dytë", e pashë një llambë me vajguri, siç përdorej dikur, por që sot më shumë ruhet si orendi kujtimi, nostalgji e një kohe...

Kolegu im e komentoi llambën që ndriçonte me vajguri. Sepse, dikur dhomat i ndriçonim me dritën që bënin këto llamba, ndërsa jashtë shtëpisë natën i përdornim fenerët, sepse qelqi që e mbështillte e pengonte erën që ta fikte. Por, edhe fenerët ishin me vajguri.

S. Krivaça

BOOM



***10 personat
më të famshëm
në TikTok
për vitin 2022***

***Kush janë
shqiptarët
më të famshëm
në botë?***

***Të famshmit
tanë
që u bënë
me fëmijë
në vitin 2022***

Lori

***falë dashuri
pa hile***



Lori falë dashuri pa hile

Emri i saj është në krye të listës së këngëtareve më të angazhuara shqiptare dhe jo rastësisht.

Lori është këngëtare e vërtetë, jo nga ato që, thjesht, i lëvizin buzët e bërtasin për të krijuar atmosferë.

Ylli i muzikës ka një karrierë të gjatë e të konsoliduar, për çka ka punuar fuqishëm ndër vite. Ka kohë që nuk e shohim shpesh në intervista, ndoshta shkak i mbrëmjeve të shumta muzikore, koncerteve, dasmave e ahengjeve.

Këtë herë, nuk kishte zemër të thoshte jo. Lori hapë zemrën në fundvit...

Lori, nga 1 deri në 10, si e vlerëson këtë vit që po e lëmë pas?

- Preferoj t'i shoh gjërat pozitivisht, nuk jam nga ata njerëz që në çdo gjë kërkojnë diçka të keqe. 2022-shi, në krahasim me dy vitet e kaluar pandemik, ishte shumë më i favorshëm. Po tregohem dashamirëse me këtë vit dhe po e vlerësoj maksimalisht.

Bekimi yt që e numëron dy herë?

- Familja, njerëzit e mi që, pavarësisht kilometrave që na ndajnë, janë gjithmonë në zemrën dhe mendjen time. Ky është bekimi më i madh i jetës, që e numëroj edhe më shumë se dy herë.

Pasuria jote më e madhe?

- Pos familjes, është shëndeti i mirë dhe, sigurisht, talenti me të cilin më ka pajisur Zoti, e që më ka bërë kjo që jam sot. Secili njeri e ka një talent, aftësi dhe dhunti unike, për të cilën duhet qenë falënderues.

Si e përshkruan dashurinë për këngën me një fjalë?

- E jashtëzakonshme.

Nëse nuk do të ishe këngëtare, me çfarë do të merresh?

- Ndoshta me dizajn të modës. Por, jam e lumtur që e kam zbuluar talentin tim herët dhe e kam orientuar angazhimin tim aty ku mund ta bëj më të mirën.

Lori, ndihesh më shumë kosovare, a shqiptare nga Shqipëria?

- Ndihem, thjesht, shqiptare. Jam këtu e atje, kudo ku ka shqiptarë. Për mua nuk ka kufij. Jemi një.

Kënga me të cilën je e lidhur më tepër?

- Kam një krijimtari të bujshme, shumë këngë me të cilat jam e lidhur vetë e është i lidhur edhe publiku im. Së fundi, ma kanë kujtuar shpesh këngën time me

titull "Amerika", e cila është unike dhe mjaft e dashur për mua.

Këndon në dasma dhe duket që bëhesh njësh me dasmorët. Si e komenton këtë?

- Në përgjithësi, jam e afërt me njerëzit, falë dashuri dhe kam respekt e mirënjohje për ata që më duan. Fundja, karrierën time e ka lartësuar dashuria e publikut.

E ndjej si timen çdo dasmë e aheng, bëhem pjesë e familjes ku jam dhe më lumturon fakti kur shoh që prania e kënga ime i bënë me disponim të mirë të gjithë.

Thuhet se ti je edhe "maestro e kuzhinës"?

- Gatimi është një nga pasionet e mija më të mëdha. Ata që gatuajnë me dashuri, përherë bëjnë mrekulli në kuzhinë. Më pëlqen të thërras miq dhe të sjellë në tavolinë receta të ndryshme.

A i beson shprehjes që thotë se "dashuria kalon nga stomaku"?

- Edhe mundet. Ai a ajo që e ka thënë, ka ditur diçka...

Të kemi parë në shumë projekte festive me këngë të mira dhe si gjithmonë duke shkëlqyer. Je lodhur, apo argëtuar më shumë?

- Të dyja bashkë. Prapa shkëlqimit ka shumë mund, lodhje e luftë me kohën. Gjithsesi, është e pamohueshme edhe pjesa e bukur e gjithë kësaj.

Pse të duan shumë koleget, kolegët e gazetarët?

- Pyesni ata (qesh)... Sepse, unë falë shumë dashuri të sinqertë e pa hile.

Një urim për Vit të Ri?

- Më shumë dashuri, respekt për veten e të tjerët, mirënjohje dhe punë. Gëzuar!

Nderim Neziri



10 personat më të famshëm në TikTok për vitin 2022

TikTok ka zbuluar 10 të famshmit dhe artistët me më shumë shikime për video në vitin 2022. Lista përmban shumë nga yjet tanë të preferuar – me numrin një që është një nga mbretëreshat absolute të TikTok-ut! Bëhet fjalë për Lizzo, e cila u bë virale me këngën e saj “About Damn Time”, që u përdor në

miliona përdorues në videot e tyre. Pjesë e listës janë, gjithashtu, shumë artistë të tjerë, si Billie Eilish, e cila edhe pse nuk është shumë aktive në rrjetin social, numëron miliona shikime në videot e saj. Gjithashtu, nuk kishte si të mungonte Doja Cat, me videot e saj virale dhe Selena Gomez. Kjo e fundit

ka qenë mjaft aktive në profilin e saj, ku ka shkaktuar edhe polemika. Kujtojmë këtu që në një video që kishte publikuar për rutinën e kujdesit ndaj lëkurës, u konsiderua nga ndjekësit dhe fansat e saj si një tallje dhe ironizim ndaj Hailey Bieber, bashkëshortes së ish-të dashurit Justin Bieber.

RENDITJA:

10. Meghan Trainor
9. Billie Eilish
8. Young Gravy
7. Nessa Barrett
6. Selena Gomez
5. Doja Cat
4. Charlie Puth
3. Bad Bunny
2. Bella Poarch
1. Lizzo

10



9




8



7



6



5



4



3



2



1



Kush janë shqiptarët më të famshëm në botë?

Kemi dëgjuar për mjaft personazhe të famshëm për të cilët spekulohet se kanë në venat e tyre gjak shqiptari, por që kjo të ndodhte për të famshmin Robert de Niro, nuk na kishte shkuar mendja. Nga aktori i famshëm Robert de Niro, Nënë Tereza, aktorja Holivudiane Liza Dushku, e deri te Rita Ora, Dua Lipa e Bebe Rexha, këta janë shqiptarët më të famshëm në botë.

NËNË TEREZA, HUMANISTE

Jo vetëm që është shqiptarja më e famshme, por është edhe shqiptarja me të cilën Shqipëria krenohet.

ROBERT DE NIRO, AKTOR

Natën e parafundit të festivalit 61 italian të këngës, Sanremo, i ftuari special, Robert de Niro, e pohoi me gojën e tij në televizionin "Rai 1" se origjinën e ka të përzierë ndërmjet Siçelisë dhe Shqipërisë. De Niro, që pa frikë mund të thuash se është aktori më i mirë në botë, në faqen zyrtare të Wikipedias, në biografinë e De Niros, shkruhet se babai i tij ka qenë shqiptar.

E, tani shqiptarët do t'i shikojnë me më shumë interes filmat e tij...

ISMAIL KADARE, SHKRIMTAR

Ismail Kadare është shkrimtar shqiptar me famë botërore dhe fitues i çmimit "Man Booker Prize".

INVA MULA, SOPRANO

Inva është sopranoja me famë ndërkom-bëtare, e cila përfaqëson denjësisht vendin tonë në skenat botërore.

ANA OXA, KËNGËTARE

Këngëtarja e njohur italiane, Ana Oxa, ka pranuar se babai i saj ka mbërritur në Itali nga Shqipëria, pikërisht nga Kruja.

SANDRA BULLOCK, AKTORE

Është bërë e ditur se babai i Sandra Bullock është me origjinë shqiptare.

JAMES BELUSHI, AKTOR

Aktori i famshëm amerikan James Belushi është me origjinë shqiptare.





FERID MURATI

Nobelisti me baba shqiptar dhe nënë amerikane, Ferid Murati, fitoi çmimin “Nobel” në mjekësi në vitin 1998.

ELIZA DUSHKU, AKTORE

Aktorja e cila luajti me Robert de Niron dhe Leonardo Di Caprion në filmin “Historia e një djali”, është me origjinë shqiptare.



EMINA CUNMULAJ, MODELE

Supermodelja me origjinë shqiptare, Emina Cunmulaj, është shpallur ylli i ri i revistës së famshme të fotomodeleve “Elite” dhe “Vogue” në SHBA.

ALAN SHEPARD, KOZMONAUT

Ai u lind në East Dery, New Hampshire, të SHBA-ve, më 18 Nëntor 1923. Është me origjinë shqiptare.

Shepardi në misionin “Apollo 4”, në Janar-Shkurt 1971, e manovroi vetë anijen kozmike.

Si kozmonaut është i pari që ka fluturuar në kozmos si amerikan dhe i pesti që ka shkëlur në Hënë. Ai vuri edhe flamurin shqiptar në Hënë.

Para daljes në pension Alan Shepard gradohet me titullin admiral.



FADIL BERISHA, FOTOGRAF

Cilësohet si fotografi më i mirë në botë. Fadil Berisha është shqiptar.

Disa nga personalitetet që janë klientë të studios së tij janë: Halle Berry, Placido Domingo, Snoop Dog, Bill Clinton, Donald Trump etj.



KARL GEGA, ARKITEKT

Karl Gega është arkitekt me famë botërore. Ai është edhe ndërtues i hekurudhës së Semmeringut.

ALEKSANDËR MOISIU, AKTOR

Moisiu adhurohet dhe respektohet në botë, por sidomos në Shqipëri, si një ndër aktorët më të mëdhenj të vendit, edhe pse ai që nga rinia e tij më nuk e vizitoi Shqipërinë.

LAURA MERSINI HOUGHTON, SHKENCËTARE

Laura është shqiptare, kozmologe dhe një nga femrat e pakta në botë që merren me shkencë.

ANDAMION MURATAJ, KINEAST

Anadomioni është shqiptar, kineast, i cili ka punuar si skenarist dhe kineast në Nju-Jork gjatë 12 vjetëve të fundit. Ka diplomuar në Universitetin Amerikan (Washington DC).

Si kineast ka xhiruar shumë filma dhe dokumentarë, ndër të cilët edhe dokumentarin “PBS Children Will Listen”.

LUAN KRASNIQI, BOKSIER

Luani është boksier më famë, i cili ka mbajtur deri vonë titullin Kampion i Evropës.

RITA ORA

Shqiptarja që ka bërë famë në tërë botën me muzikën e saj është Rita Ora. E ardhur në Londër nga Kosova, qëkur ishte dyvjeçare, ajo ka arritur të jetë në top-listat në Angli e Amerikë.

Të famshmit tanë që u bënë me fëmijë në vitin 2022

Viti 2022 ka qenë një vit me plot surpriza për disa nga personazhet publikë në vendin tonë. Disa nga ta provuan ndjesinë e të bërit prindër për herë të parë. Në "Boom" prezantojmë VIP-at që sivjet u lumturuan nga ardhja në jetë të të vegjëlve të tyre...



ARIAN AGUSHI

Këngëtari Arian Agushi, i njohur me Gold Ag, sivjet u bë baba për herë të dytë me një djalë të mrekullueshëm.



SHPAT KASAPI

Këngëtari Shpat Kasapi u bë baba për herë të parë, pasi në jetë i erdhi i biri, të cilin çifti e quajtën Roel. Të voglin nuk e kanë kursyer nga ekspozimi në rrjete sociale.



ARBANA OSMANI

Moderatorja e njohur Arbana Osmani u bë nënë për herë të tretë, por për herë të parë e një vajze, e quajtur Zoi. Arbana shpejt u kthye në formë dhe nisi me projektin e madh "Big Brother VIP Albania".



DOJNA MEMA

Moderatorja e njohur shqiptare u bë nënë e një djali, që po e priste me padurim. Për të ishte dhurata më e bukur që mund t'i sillte viti 2022 prezantueses së këndshme nga Shqipëria.



ROBIN DHE MARIGONA KRASNIQI

Çifti i njohur dhe shumë i përfolur, Robin dhe Marigona Krasniqi, morën epitetin prind për herë të parë nga djali i quajtur Mayson. Çifti po shfaqen më të lumtur se kurrë më parë...



EINXHEL DHE DJ DAGZ

Çifti i njohur, Einxhel dhe Dj Dagz, javë më parë u bënë prind. Ata nuk publikuan ndonjë fotografi me foshnjën, por, siç kuptojmë, foshnja quhet Trev.



allure
BEAUTY



Ju von Geznar Festat!

January

S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

February

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28				

March

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

April

S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30						

May

S	M	T	W	T	F	S
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

June

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	

July

S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

August

S	M	T	W	T	F	S
	1	2	3	4	5	
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

September

S	M	T	W	T	F	S
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

October

S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

November

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
27	28	29	30			

December

S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

Cila femër shqiptare u martua për të dënuarin me 101 vjet burg?

“Edhe pse i fejuari i saj ishte dënuar me 101 vjet burg, Marta, 23 vjeçare, nga fshati Skuraj i Mirditës, nuk pyeti për presionet e Sigurimit të Shtetit dhe u martua me të fejuarin e saj, i dënuar me 101 vjet burg!

Në vitin 1947, Martja, e bija e Zef Gjok Pjetrit (Përvizi), me guximin e një 23-vjeçareje, pa asnjë dilemë u tha në bisedë nënës së saj dhe vjehrrës së ardhshme se nuk ka me e thyer besën e babës së vranë, i cili me ndërhyrjen e nipit të tij, Mark Gjon Markut, ishte vendosur të ishte nusja e Bib Frok Gjomarkut.

“Nëse kohët do ishin ndryshe, unë do të isha nuse në derë princore. Por, meqë kohët kanë ndryshuar, unë prapëseprapë do jem nuse në atë

derë, për sa kohë ai të jetë i gjallë, edhe pse burri im i ardhshëm është dënuar me 101 vjet burgim”, ishte shprehur Martja.

I dënuari me 101 vjet burg, personazhi i kësaj historie, Bib Frok Gjomarku, i kishte ndjekur studimet për Inxhinieri Ushtarake në Firencë të Italisë. Por, pas diplomimit, me të mbërritur në Mirditë, në vitin 1945, u bashkohet çetave të rezistencës antikomuniste nën komandën e Mark Gjon Markut. Në vitin 1946, në moshën 33 vjeçare,

Bib Frok Gjomarku arrestohet dhe çohet në burgun famëkeq të Shkodrës. Pas torturash çnjerëzore, trupi gjykues e dënon me pushkatim, por në gjykimin vijues në Gjykatën e Apelit dënimi me pushkatim i zbritet në 101 vjet burg.

Pasi u vendos dënimi me 101 vjet burg, rrethi miqësor i vajzës nga Skurajt të Mirditës, sugjeronin që kjo miqësi të prishej, falë ndërhyrjeve të fshehta të regjimit komunist që po instalohet me shpejtësi.



Martja në moshën 23- vjeçare

Por, këtë mund ta zgjidhte vetë vajza, po ajo këmbëngulë, duke thënë: “Unë nuk e koriti babën e pushkatuar dhe se sa të kem dijeni se ai është gjallë, do jem nusja e tij”.

SI U BË MARTESA MARTËS ME BIB FRROKUN NË BURG?

Caktohet data e martesës. Ishte viti 1947, kohë kur Martja do të mbërrinte në fshatin Ndërfushas, për t’u larguar vetëm kur kaloi në amshim, në vitin 2002.

Por, nuk vonoi shumë dhe për nusen re, Martën, nisi kalvari i vuajtjeve. E rritur në një derë të kamun, nusja e re fillon një jetë plot vuajtje dhe trajtim çnjerëzor, pasi kulla e Gjomarkajve ishte djegur, pasuritë i ishin sekuestruar dhe e vetmja mundësi mbijetese ishte puna në prerje të lëndëve drurore në pyje, në këmbim të triskave për miell dhe ushqim.

Nusja e re shkon në burg së bashku me kunatin Gjon Frrok Gjomarkun dhe vjehrrën për të parë bashkëshortin, por ndeshet me mos aprovimin dhe sugjerimin e tij. “Mos e humb jetën, je e lirë, pasi fati im nuk dihet”, i thotë Biba.

Por, nuk kaloi shumë dhe Martja e pa veten në internim në Berat. Dhe, në internim bëri jetë që nga viti 1947 e deri më 1952. Më pas kthehet në fshat, duke punuar për mbijetesë, pa asnjë pronë, tokë apo çati mbi krye. Por, për fat të mirë, pas 14 vjet vuajtjesh burg, pikërisht në vitin 1960, pas disa amnistive, del nga burgu burri i saj, Bib Frrok Gjomarku, për t’ju bashkuar nuses së tij, e cila, kurrë nuk hoqi dorë edhe në kushtet më të vështira ekonomike, fizike e psikologjike prej tij.

A. Ndoja



S'po di kah me ia nis!



Shkenda Dubova
Qendër **dobësimi**

*Gëzuar festat
e fundvitit!*

SHËNDET E MBARËSI,
KËTË VIT TË RI.



FISNIK SYLA

*Gezuar vitin e ri 2023 !
Shendet, paqe, lumturi
dhe harmoni ne familjet e juaja !*





Pash ëndërr se u bëra deputet!

Populli ynë është i çuditshëm për shumë arsye: Një, sepse ia ka dhënë votën shumëkujt që nuk e ka merituar! Ka kryetar komunash që nuk e dinë matematikën e qeverisjes e as të menaxhimit! Ka kryetar dhe njerëz që udhëheqin shtetin, e kurrë nuk kanë qenë as zot të shtëpisë së vet dhe nuk kanë udhëhequr as me kuletën e shtëpisë, e që nuk dinë sa kushton buka, vaji, sheqeri!

Kanë zënë pozita me rëndësi njerëzit që i sulmojnë kolegët e vet edhe pa pasur fare fakte! Të tillë që janë shumë agresivë dhe policë që e kanë vënë revolen në brez dhe imitojnë kreshnikët si në ciklin e këngëve të Mujës e Halilit!

EDHE MË I KEQI TË VRET!

Populli e ka një fjalë të urtë, e që thotë: "Edhe më i keq i të vretit!"

E, kur është fjala te më i keqi, po e sjell një shembull i cili ka emër e mbiemër, por që po e kursej, sepse emri i tij nuk është më interesant se ngjarja.

Një burrë shkurtabiq i fshatit tim, në vitet 70 fejohej me një vajzë të fshatit fqinj. Ditë pas ditësh, babai i vajzës së fejuar e kupton se dhëndri ishte i shkurtë dhe i qon fjalë se fejesa do të prishet.

Shkurtabiqi i thotë se për robin tim qes pushkë...

Dhe, shkëmbim pas shkëmbimi fjalësh, një ditë shkurtabiqi i del në rrugë babait të së fejuarës dhe i thotë se e kërkon nusen. Ai e kërcënon shkurtabiqin dhe i thotë se ti për të më frikësuar mua duhet të rritesh sa unë! Shkurtabiqi nxjerr revolen dhe shtie në të dhe vret baballëkun dhe dorëzohet në polici.

"Çka të ka sjellë Zoti këtu?", e pyesin policët.

Shkurtabiqi u thotë: "E kam vvarë babanë e të fejuarës!"

Policët nisin të qeshin...

"Edhe ti ke mundur ta vrasësh dikë, a?!", i thonë. "Po, qe revolja!", ua kthen ai.

Dhe, kur shkojnë në vendin e ngjarjes shohin se e vërteta ishte sikur thoshte shkurtabiqi...

Por, ka edhe më keq!

POSHTË KA RËNË GAZETARIA!

Duke dëgjuar një raport për punën e Kuvendit të Kosovës në radion që e kam në veturë, dëgjoj raportimin e një gazetareje, së cilës po i kursej emrin. Ajo, duke përdorur fjalën "organizim" përdorte fjalën "organizativ"!

Andaj, u befasova deri ku ka shkuar analfabetizmi gazetaresk!

Por, ka edhe më keq!

Po ua shpjegoj një ëndërr timen që e pashë këto ditë. Nuk doja të bëhesha deputet i Kuvendit të Kosovës, por e kisha mundësinë! Ëndërr e mirë, por e perealizueshme në praktikë...

Sokol Murturi



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE



**We bring the future
to the present...**



nPeshk
TERRACE



Gezuar
Viti i ri

Kontakti:
045/840-850
045/233-211

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Nuk e dua burrin!

Jam 34 vjeçare, jetoj në Prishtinë. Jam martuar qe 8 muaj, por nuk e dua burrin.

Jam e shtrënguar të duroj kështu deri në fund të jetës apo do më lerë ky mua, për çka do më bënte të lumtur sikur të ndaheshim?

“E dëshpëruara”

Përgjigje:

Ke qenë shumë vjet në lidhje me njeri të martuar, por nuk ke bërë zgjidhje. Prandaj, familja, duke mos pasur rrugëdalje tjetër, ka vendosur martesën tënde me dikë që është i ndarë pas 8 vitesh martesë... Nëse ti ndahesh prej tij apo nëse ai të lë ty, ti do të rikthehesh te lidhja e vjetër, prandaj po kërkon që të kthesh aty ku do. Megjithatë, ti nuk ia bën

burrit jetën të lumtur, përderisa grindeni çdo ditë e çdo natë, duke jetuar me inate kundër njëri-tjetrit. Në këtë mënyrë, asnjëri nuk e keni jetën të lumtur, për çka sugjerimi im është të ndaheni.

E zura burrin me femër tjetër!

Jam 25-vjeçe, jetoj në Belgjikë. I kam dy fëmijë. Ka një kohë që unë dhe burri zihemi qoftë edhe për asgjë! Para një viti ka pasur një lidhje me një femër belge, por e diktova dhe thotë se më nuk ka lidhje me të. A është ende në lidhje me të?

Përgjigje:

Arsyeja pse ju grindeni është thikë me dy tehe:

“Vesa”

Tehu i parë është se ti je mbushur xheloz për shkak të asaj lidhjeje që e ka pasur burri yt, ndërsa ai është mbushur inati që ti e ke kapur në flagrancë.

Dhe, në vend se ta largoni inatin, ju e kultivoni edhe më shumë!

Ajo që duhet ta bësh ti, pa humbur kohë, është ta harrosh rastin e lidhjes së tij.

Por, jo vetëm ta harrosh, edhe t'i thuash se e ke harruar dhe se për ju më e mira gjë është ta riktheni besimin te njëri-tjetri.

Kam frikë të rri vetëm!

Jam 65-vjeçare, i kam katër fëmijë. Jetojmë në Zvicër. Burri më ka vdekur para tre vjetësh dhe kam mbetur e vetmuar, sepse fëmijët secili e ka familjen e vet. Por, ka nja tre muaj që e kam një frikë në momente të caktuara. Kur më shkon mendja te gjërat e këqija, ndihem se po kaloj në frikë. Si ta kaloj këtë gjendje?

“Mejremja”

Përgjigje:

Të përmendurit e Allahut xh. h. është prej rëndësisë

së parë dhe themelore për të jetuar njeriu pa frikë. E kam fjalën në pikëpamjen e moshës kur njeriu afrohet më afër viteve të moshuara, e që e mendon më shumë për vdekjen. Dhe, duke qenë e lidhur me Zotin e madhërishëm, njeriu përjashton nga shpirti frikën, xhelozinë, haramin dhe i ofron të mirat, e që janë pjesë përbërëse e parajsës. Muhamedi a. s. ka thënë: "A doni t'u tregoj për veprën më të mirë, më të dashur tek All-llahu, me të cilën fiton shpërblimet më të larta tek Ai?". E, ata që e dëgjonin, i thanë po. Muhamedi a. s. tha: "Të përmendurit e All-llahut!". Pra, bë namaz, sepse duke bërë një gjë të tillë përfiton lidhjen më të ndritshme me Allahun xh. h.

Vajza nuk pranon të martohet!

Jam nënë e dy vajzave dhe e dy djemve. Kam probleme me vajzën e madhe, e cila po synon të doktorojë. Andaj, për martesë nuk dëshiron të flasë.

A mos e ka fatin e mbyllur?

"Nëna e brengosur"

Përgjigje:

Vajza nuk e ka fatin e mbyllur dhe mos e pengoni të doktorojë. Me vetë faktin se ajo po e fiton këtë titull, nuk është ngushtë për mësimin tuaj.

Në vend se t'i thuhet vajzës doktoro dhe ne të përkrhim, ju mundoheni ta bindni të martohet! Martesën e gjen kur të dojë a doktoraturën jo!

A po më tradhton burri?

Përsëritet, jam 43-vjeçare, jetoj në Prishtinë. Jam nënë. Arsyeja që po u shkruaj është dyshimi se po më tradhton

burri. Kurrë nuk kam menduar se do të ndodhë kjo dhe këtë dyshim e mbështes te fakti se para dy javësh ia pash në telefon

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

disa foto të një femre!

A është e vërtetë?

"Gruaja e dëshpëruar"

Përgjigje:

Të drejtë dyshimi ke, por dyshimi nuk është argument mbi të cilin mund të veprosh duke e shprehur zemërimin tënd!

Sikur ta kishe parë atë femër me burrin tënd në ndonjë mënyrë amorale, ajo jep një kuptim dyshimi. Por, meqë e ka punëtore, do të thotë se edhe po të kenë qenë në foto bashkë, kjo nuk të jep arsye për dyshime, sepse dyshimi nuk është argument.



SHERWOOD
Resorts and Hotels

feel the legend



SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER
KEMER / ANTALYA

SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA
LARA / ANTALYA

SHERWOOD
DREAMS RESORT
BELEK / ANTALYA

TUI BLUE
BELEK
BELEK / ANTALYA

SHERWOOD
PREMIO HOTEL
LARA / ANTALYA

www.sherwoodhotels.com.tr